

Nr. Prot. 054/B/20

VENDIMI Nr. 1643

Për

Përcaktimin e ndërmarrjes "IPKO Telecommunications" L.L.C.

si

'Ofrues me Fuqi të ndjeshme në Tregun e Terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale'

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 10, paragrafi 5), neni 31, paragrafët 1), 4), 6) dhe 12), neni 32, neni 33, neni 36, neni 37, neni 40 dhe neni 79, paragrafët 1) dhe 2) (*tutje referuar si - Ligji*); Rregullores Nr. 42 për Analizat e Tregut, (*Ref. Nr.Prot. 110/B/19*), neni 3, paragrafët 3.1), 3.3) dhe 3.4), neni 4, paragrafi 4.3.2) (*tutje referuar si - Rregullorja për Analizat e Tregut*), Rregullorja Nr. 36 për Shërbimin e Interkoneksionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike, (*Nr.Prot.028/B/20 - tutje referuar si - Rregullorja për interkoneksion*); Direktivës 2002/21/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 7 Mars 2002 për Rrjetat dhe Shërbimet e Komunikimeve Elektronike (Direktiva Kornizë), Rekomandimit të Komisionit Evropian (2003/311/EC), e ndryshuar me Direktivën 2009/140/EC, së bashku me rekomandimin (2007/879/EC) e pasuar me atë të datës; 17 Dhjetor 2007 mbi produktet dhe shërbimet relevante të tregjeve të ndjeshme me rregullimin *ex-ante*; Udhërrëfyesin e Komisionit Evropian mbi analizën e tregjeve dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg sipas kornizës rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2002/C 165/03); Vendimit Nr.1529 për Fillimin e Procesit të Analizës së Tregut të Terminimit të Thirrjeve me zë në rrjetet mobile individual të datës; 04/03/2020 (*Ref. Nr. Prot. 013/B/20*); në përputhje me dispozitat e nenit 13 paragrafi 1 dhe 5 i Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i ARKEP i përbërë nga:

- 1) z. Nijazi Ademaj Anëtar i Bordit
- 2) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 3) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit
- 4) z. Shqiprim Pula Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 57-të, të mbajtur me datë; 02 Tetor 2020, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Departamentit për Komunikime Elektronike (DKE) për analizën e tregut të Telefonisë mobile dhe përcaktimin e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), vendosi si më poshtë:

V E N D I M

Faqe 1 nga 5

- I. Operatori **IPKO Telecommunications LLC** përcaktohet ndërmarrës me fuqi të ndjeshme në tregun e ‘**Terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale**’.
- II. Operatori **IPKO Telecommunications LLC** i përcaktuar si Ofrues me Fuqi të Ndjeshme në Treg detyrohet të vazhdoj të zbatojë detyrimet e përcaktuara në bazë të Ligjit dhe Rregullores për Analiza të tregut, neni 6.3, si në vijim:
- 1) Obligimi i Qasjes;
 - 2) Obligimi për mos-diskriminim;
 - 3) Obligimi i Transparencës;
 - 4) Obligimi për Kontrollin e Çmimeve dhe llogaritje të Kostos.
- III. Detyrimet e përcaktuara në pikën II të këtij vendimi përfshijnë:
1. **Obligimi i Qasjes** duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 36 dhe 37 të Ligjit dhe nenit 6.3 të Rregullores për analiza të tregut.
 - 1.1) **IPKO Telecommunications LLC** duhet të ofroj interkoneksion dhe terminim të thirrjeve në rrjetin mobil sipas kushteve dhe procedurave të miratuara nga ARKEP me Rregulloren për Interkoneksion.
 2. **Obligimi për mos-diskriminim** duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 33 të Ligjit dhe nenit 6.3 të Rregullores për analiza të tregut.
 - 2.1) **IPKO Telecommunications LLC** nuk duhet të veprojë në baza jo diskriminuese të përfituesit e terminimit të thirrjeve mobile ndaj përfituesve tjerë dhe në veçanti të aplikojë kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ndërmarrjet tjera që ofrojnë shërbime ekuivalente , dhe t’u ofrojë shërbime dhe informata të tjerëve nën kushte të njëjta dhe të të njëjtës cilësi që ajo ofron për shërbimet e saj ose ato të njësisve apo filialeve të saja.
 3. **Obligimi i Transparencës** duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 34 të Ligjit, dhe nenit 6.3 të rregullores për analizat e tregut.
 - 3.1) **IPKO Telecommunications LLC** sa i përket produkteve të terminimit me shumicë obligohet që;
 - 3.1.1) brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi, të publikoj ofertën referente sipas Rregullores për Interkoneksion;
 - 3.1.2) t’u siguroj ndërmarrjeve që kërkojnë interkoneksion të gjitha informacionet e nevojshme për t’u ndërlidhur.

4. Obligimi për kontrollin e çmimeve dhe llogaritjen e kostos duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 40 të Ligjit dhe nenit 6.1, të Rregullores për analizat e tregut. **IPKO Telecommunications LLC**, sa i përket ofrimit të terminimit të thirrjeve mobile do të siguroj që;

4.1. Çmimet e terminimit të thirrjeve mobile të origjinuara brenda territorit Republikës së Kosovës nuk janë më të larta se çmimet e dhëna në tabelën në vijim:

Periudha	01 Tetor 2020	01 Janar 2021	01 Janar 2022
MTR në eurocent/min	1.046	0.946	0.846

4.2. Për Çmimet e terminimit të thirrjeve të origjinuara jashtë Republikës së Kosovës (thirrjet ndërkombëtare), **IPKO Telecommunications LLC** do të negocioj në mirëbesim me palët që kërkojnë qasje dhe do të siguroj se çmimet e terminimit në rrjetin mobil të saj për thirrjet e origjinuara jashtë Kosovës janë në nivel të arsyeshëm;

4.3 Tarifat e përcaktuara më lartë do të vlejnjë deri sa ARKEP të vendos metodologjinë e llogaritjes së kostos në përputhje me parimet e përcaktuara me nenin 40 të ligjit, në mënyrë që të llogaritet kostoja për ofrimin efikas të terminimit të thirrjeve mobile;

4.4 Mos të kërkohet nga konsumatorët të paguajnë për shërbimet/objektet, të cilat nuk janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të Terminimit të thirrjeve;

4.5 Sa i përket terminimit të thirrjeve mobile, linku i interkoneksionit është i rregulluar si pjese shoqëruese, prandaj **IPKO Telecommunications LLC** duhet të;

a) ofroj linkun e interkoneksionit palës kërkuese;

b) lejojnë palës tjetër interkonektuese për të instaluar dhe për të ofruar linkun e interkoneksionit ndërmjet **IPKO Telecommunications LLC** dhe rrjetit të tij në rast se ky operator propozon çmim më të ulët se sa çmimi i ofruar nga **IPKO Telecommunications LLC**;

c) të ndajnë kostot e linkut të interkoneksionit ndërmjet palëve të interkonektuara në proporcion me përdorimin e këtij linku të interkoneksionit - d.m.th **IPKO Telecommunications LLC** - është e detyruar për të mbuluar pjesën e trafikut të **IPKO Telecommunications LLC** në trafikun e përgjithshëm të bartur nga kjo lidhje interkoneksioni gjatë muajit të caktuar. Supozohet se operatori ofron një shërbim për një operator tjetër, nëse ky i fundit zotohet të paguaj për atë shërbim operatorit të parë. Gjithashtu konsiderohet se është vetëm një link interkoneksioni ndërmjet rrjeteve publike telefonike, pavarësisht linkut 2Mbps që realisht përdoret për rutimin e trafikut. Në rast se vetëm terminimi i thirrjeve mobile është i ofruar nga **IPKO Telecommunications LLC** tek

operatorët tjerë, ky operator duhet të mbulojë 100% koston e linku të tillë të interkoneksionit.

IV. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Autoriteti me vendimin Nr.1529 (Ref. Nr.Prot. 013/B/20) ka filluar procesin e analizës së tregut; 'Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile Individuale'.

Procedura e analizës së tregut sipas neni 31, paragrafi 4) i Ligjit përfshijnë fazat si në vijim:

- përcaktimi i tregut relevant (produkti/shërbimi dhe shtrirja gjeografike), karakteristikat e të cilit mund të jenë të tilla për të justifikuar imponimin e detyrimeve referuar në nenin 32 të këtij ligji;
- analizimi nëse tregu relevant ka konkurrencë efektive dhe në rastin kur nuk ka konkurrencë efektive, identifikimi i ndërmarrjeve me FNT në atë treg;
- imponimi, korrigjimi dhe/ose anulimi i detyrimeve të referuara në nenin 32 të Ligjit në lidhje me ndërmarrjet me FNT.

Gjatë procesit të Analizës së Tregut '**Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet mobile individuale**', ARKEP i ka dërguar pyetësorët operatorëve (MNO): "**Telekomit të Kosovës**" Sh.A. dhe "**IPKO Telecommunications**" LLC. Po ashtu pyetësori i është dërguar edhe ndërmarrjes mts D.O.O., e cila posedon autorizim të përkohshëm dhe operon në kuadër të një infrastrukture të kufizuar, kryesisht në veri të vendit.

Duke pas parasysh atë që u tha më lartë dhe nga të dhënat e dorëzuara nga operatorët, si dhe sqarimet esenciale të ndërmarrjeve të pyetura janë paraqitur dhe vlerësuar në Raportin '**Analiza e Tregut të Telefonisë mobile dhe Përcaktimi i Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT)**'.

Në bazë të Raportit Tregu i terminimit të thirrjeve në rrjetin mobil është përcaktuar si treg relevant për ndërmarrjen **IPKO Telecommunications LLC**.

Analiza e tregut ka treguar se konkurrenca në tregun përkatës nuk është efektive duke u bazuar në faktorët si në vijim;

- **IPKO Telecommunications LLC** ka pjesëmarrje 100% të tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetin e saj mobil dhe konkluzionet shtesë që argumentohen në raport si në vijim:
 - Mungesa e fuqisë blerëse kundërvepruese në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve mobile për shkak të barrierave teknologjike;

- Mungesa e konkurrencës për shkak të barrierave teknologjike

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Shtojcë:

Këtij vendimi i bashkëngjitet Raporti për Analizat e Tregut të Telefonisë Mobile dhe Përcaktimin e Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg.

Prishtinë, 20/10/2020

Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Aktvendimi i dërgohet:

- Telekom i Kosovës SH.A.
- IPKO Telecommunications LLC
- Mts d.o.o.
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Arkivit të ARKEP-it.